



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL ^{1 2}

(I përmbledhur)

Tiranë, më 06.02.2020, ora 15.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

2. Shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

3. Ngritjen e një grupi pune për hartimin e rregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve, për të përmbushur angazhimin e deklaruar të KED-së 2019 në nenin 22 të Rregullores së Brendshme.

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni 232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

² Bashkëlidhur procesverbalit, për qëllime të njohjes nga kushdo i interesuar, gjenden projektvendimet me relacionet përkatëse të cilat janë në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje.

Marrin pjesë :

- | | |
|------------------------|------------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 4. Arta Marku | (anëtare) |
| 5. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 6. Saida Dollani | (anëtare) |
| 7. Ludovik Dodaj | (anëtar) |
| 8. Arjan Qafa | (anëtar) |
| 9. Marsida Xhaferllari | (anëtare zëvendësuese) |
| 10. Bilbil Mete | (anëtar zëvendësues) |
| 11. Nezir Gjoka | (anëtar zëvendësues) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

1. Nejlja Peka, komisionere, e pajisur me autorizimin nr. 60 prot., datë 31.01.2020, lëshuar nga Avokati i Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj dhe Katrin Treska, përfaqësues të Presidentit të Republikës, të pajisur me autorizimin nr. 446, datë 29.01.2020, lëshuar nga Presidenti i Republikës.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetës me konsulencë në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore të KED :

1. Michelle Lakomy, këshilltare ligjore rezidente pranë OPDAT
2. Xhoana Kovaçi, përkthyesë për OPDAT

HAPET MBLEDHJA - ora 15:14

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaroi të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, informon se të gjithë anëtarët e Këshillit janë të pranishëm, po ashtu edhe anëtarët zëvendësues, me përjashtim të z. Nazmi Troka. Gjithsesi, në rastin e anëtarëve zëvendësues, është e drejta e tyre të marrin pjesë në mbledhje, nuk është çështje detyrimi. Sipas komunikimit, Avokati i Popullit nuk mund të jetë vetë i pranishëm për shkak të një angazhimi tjetër zyrtar, por do të përfaqësohet nga znj. Nejla Peka, e cila do të bashkohet mbledhjes pak më vonë.

Në lidhje me rendin e ditës, sipas dakordësisë në përfundim të mbledhjes së mëparshme, është e parashikuar të shqyrtohen të njëjtat çështje. Në vijim të diskutimeve të mbledhjes së kaluar, pas përfundimit të shqyrtimit të dy pikave të para të rendit të ditës, Këshilli është në procesin e shqyrtimit të pikës së tretë, projektaktit “*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*”.

Këshilli informohet edhe se, për shkak të kohës shumë të shkurtër, ka qenë e pamundur përgatitja e procesverbalit të përmbledhur të mbledhjeve të datave 3 dhe 5 Shkurt, të cilat kanë pasur një kohëzgjatje prej 4 orë pa 10 minuta dhe 4 orë e 33 minuta.

Anëtarët e Këshillit miratojnë vijimin e mbledhjes me të njëjtin rend dite.

Këshilli vijon punimet e mbledhjes sipas rendit të ditës, me shqyrtimin dhe diskutimin e nenit 7 të projektvendimit “*Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*”, për një ndryshim në pikën 43 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke përcaktuar rregullin se kryetari i këshillit voton i fundit.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 7 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 43 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehim mendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e nenit 7 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 43 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e dispozitës së nenit 7 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 43 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Saida Dollani, Nezir Gjoka** dhe **Arjan Qafa**. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Arta Marku, Miranda Andoni** dhe **Ludovik Dodaj**. Me rezultatin e votimit 4 vota pro dhe 5 kundër, ky propozim nuk miratohet.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas votimit, duke kërkuar ndjesë për faktin që pjesëmarrësve të tjerë në mbledhje nuk iu dha mundësia të japin mendim lidhur me propozimin për një ndryshim në pikën 43 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për të cilin anëtarët diskutuan dhe votuan për mospranimin e tij, si një çështje e diskutuar dhe votuar edhe në projektvendimin për shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të KED, fton të parashtrorët mendimet e tyre pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtron se nuk ka problem sepse kam qenë në të gjitha diskutimet. Siç kemi shprehur edhe në mbledhjen e kaluar, edhe vitin e kaluar, nuk ka ligje fikse e jo më akte nënligjore. Ato ndryshojnë. Përderisa në mbledhjet e këtij organi nuk janë finalizuar me një vendim për gjithë paketën e ndryshimeve në një votim në tërësi, do të ishte mirë të rishikoheshin qëndrimet dhe në dy mbledhjet e tjera që ky rregull të vihet në zbatim. Ligji për organet kolegjiale është i qartë. Arsytet janë objektive që të propozohet ky ndryshim dhe kështu nuk ka përse mos pranohet. Tani që ky propozim u rrëzua do të kërkoja këshillit ta rihedhë edhe një herë në votë sepse është një rregull i mirë ai që propozohet, pra që kryetari voton i fundit. Kemi qenë pjesëmarrës kur kemi hartuar aktet, formati i parë i të cilave ka ardhur nga Euralius dhe formati i dytë ka ardhur nga një anëtar i këshillit. Ato kanë pësuar evoluim të vazhduar në dispozita edhe pse është votuar nga Këshilli, deri sa është miratuar e gjithë paketa. Pra nuk është se është një rregull i ri por një normë që po përmirësohet. Këshilli këtu është. Nëse 2/3 e këshillit bie dakord, e vendos edhe njëherë në procedurë.

Michelle Lakomy (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtron se jemi koordinuar me Euralius në lidhje me diskutimin e sotëm. Ne nuk kishim kundërshtim me propozimin e bërë që kryetari të votojë i fundit, por, njëkohësisht ishte e rëndësishme që rregulloret të jenë konsistente.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë edhe njëherë pas rezulttit të votimit, nëse do të ishte e mundur ta përsërisnin diskutimin, shprehjen e qëndrimit dhe votimin për këtë rregull.

Gjatë diskutimit mes anëtarëve, paraqitet në mbledhje përfaqësuesja e Avokates së Popullit, znj. Nejla Peka .

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, duke konfirmuar votimin e sotëm, vlerësuan që të ketë një diskutim tjetër në mbledhjet e ardhshme të Këshillit, duke sjellë propozime për radhën e shprehjes së qëndrimeve dhe votimit të kryetarit të këshillit.

Këshilli vijon punimet e mbledhjes sipas rendit të ditës, me shqyrtimin dhe diskutimin e nenit 8 të projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, për një ndryshim në pikën 84 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 8 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 84 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehim mendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e nenit 8 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 84 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Nejla Peka, merr fjalën dhe parashtron se në gjykimin tonë ndryshimi i propozuar është me vend. Për analogji, dakord, ligji nr.84/2016 ka parashikuar procedurën e veçantë që kryen DSIK si organ i ngarkuar nga ky ligj për të bërë kontrollin e figurës së kandidatit, por bëhet fjalë për ata subjekte të cilët janë pjesë e sistemit. Në rastin konkret në KED vijnë edhe kandidatura që janë nga jashtë sistemit, p.sh një avokat, është në profesion i lirë. DSIK nuk e ka fare në *data base* të të dhënave sepse është institucion varësie e Kryeministrit. Ka *data base* të personave që mund të konkurrojnë nga institucioni që mbulon apo edhe nga një prej ministrive apo institucioneve qendrore të varësisë. Por, për një profesion të lirë sa garanci ka informacioni i servirur KED-së nga DSIK. A është i mjaftueshëm ai për të gjykuar për kontrollin e figurës dhe integritetin e kandidatit ? Ai nuk ka lidhje fare, nuk ka punuar asnjë ditë në shtet. Zakonisht për kandidaturat që vijnë nga administrata, në pjesën më të madhe, DSIK i njeh, i ka të listuar, shumë prej tyre mund të jenë të certifikuar prej saj dhe kanë plotësuar atë formularin e posaçëm që i certifikon për tu njohur me informacion të klasifikuar, tepër sekret apo konfidencial. Pra në rastin kur vjen nga jashtë sistemit sa i garantuar është informacioni i servirur nga DSIK. Kështu që e gjejmë vend dhe besoj se nuk përbën problem nëse i drejtoheni edhe institucioneve të tjera ligjzbatuese që po Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi i ka ngarkuar me këtë detyre.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtrohet se për të sjellë në kujtesë të gjithë anëtarëve të këtij Këshilli, në thelb janë dy çështje, nuk është një. Ka qenë një diskutim i gjatë me këshillin e kaluar i cili ka nisur që kur u hartuan aktet nënligjore dhe që është rindezur kur filloi procesi i verifikimit të kandidatëve, hartimi i relacioneve ku aty përmendet DSIK dhe ka vazhduar deri në momentin fundor, përpara pikëzimit, diku nga muaji gusht. Është diskutim jo i vogël sepse mënyra se si propozuesja e këtij ndryshimi e arsyeve është shumë e drejtë. Cila është në thelb çështja që nuk shkon? Është neni 84 i kësaj rregullore “jo me vonë se 5 ditë” relatori kryen veprime për kërkimin e informacionit mbi pengesat ligjore sipas shkronjave “a” dhe “c” të pikës 18 dhe zbatim më poshtë “...ndalimi i kandidimit vendoset kur nga Prokuroria e Përgjithshme dhe institucionet e tjera të përmendura në këtë seksion konfirmohet se kandidati ka lidhje apo kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës, aktualisht, jo ata të para `90. Nuk mundet kurrsesi sipas ligjit të DSIK-së që të kryejë një proces filtrues për KED-në. Do të duhet që KED të drejtohet SHISH, SHIU, SHÇKB siç e ka bërë apo institucioneve të tjera, por jo të ia filtrojë informacionin që i vjen nga një institucion që varet direkt, jo indirekt, madje emërohet nga Kryeministri. Për çfarë po punon ky Këshill? Për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese që do të kontrollojnë vendimmarrjen e Kryeministrit. Nuk shkon fare sepse sikur të mos kemi tjetërsim të të dhënave, ai institucion që krijon informacion të klasifikuar për një kandidat, po marr si shembull veten, Bledi, që ka lidhje dhe kontakte të papërshtatshme, informacionin që ka krijuar mund ta analizojë vetëm ai. Si ka ardhur e dhëna, kur është krijuar, cili është niveli i besueshmërisë së informatorit etj. Por jo të vejë DSIK të marrë informacion bruto dhe ta transmetojë automatikisht dhe në mënyrë të interpretuar prej tij. Kjo nuk shkon. Kështu që Presidenti i Republikës një vit rresht ka qenë pro ndryshimit të kësaj praktike dhe informacioni nga ky Këshill të merret drejtpërdrejt nga institucionet që e kanë krijuar informacionin. Nuk ka institucion në Republikën e Shqipërisë që të mos ti përgjigjet Këshillit. Nëse kjo ndodh është për të shqetësuar dhe për të mbajtur përgjegjësi. Nuk mund të thuhet që do ta ruajmë këtë rregull sepse kemi pasur këtë praktike dhe nga praktika që kemi pasur nuk na kanë lindur probleme. Jo, kanë lindur probleme. Janë bërë objekt debati në këtë Këshill.

Michelle Lakomy (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtrohet se e kemi sërish opinionin të përbashkët me Euralius. Dispozita e propozuar mund të ishte e pranueshme. Megjithatë, edhe praktika e deritanishme është me vlerë për vendimmarrjen tuaj për tu siguruar nëse duke e ndryshuar do të jeni apo jo në gjendje të merrni informacionet që ju nevojiten për të marrë vendimet e duhura. Kjo praktikë sigurisht është marrë nga praktika e institucioneve të

vetting-ut dhe duke pasur parasysh zhvillimet dhe transformimet e institucioneve të reformës së drejtësisë. Por është e rëndësishme që KED të shikojë propozimin e ri, ndërkohë që duhet të konsiderojë si është praktika aktuale. Nuk do të kishim kundërshti me propozimin por duhet të shikohet se si ndikon në aftësinë tuaj për të marrë informacionin. Çelësi qëndron në faktin se ndërkohe ju e keni aksesin tek agjencitë që ju nevojiten për të mbledhur informacionin. Propozimi që keni është të zëvendësohet rregulli që keni aktualisht. Mundet që të përfshini të dy zgjidhjet, pra edhe agjencitë e tjera që përmenden këtu në funksion të të pasurit më shumë akses dhe mjete për të mbledhur informacionin që ju nevojitet. Sikurse anëtarë e shprehën, ju mund të kërkonit informacion dhe ndoshta nuk ju bëjnë me dije se nuk ua përcjellin informacionin juve drejtpërdrejt. Kështu që ju mbetet përgjegjësia nëse do të mund ta merrni këtë informacion. Në praktikë pastaj mbetet që të ishte institucioni të cilit mund ti drejtoheni për të marrë këtë informacion dhe kjo do të ishte e dubishme për ju. Në praktikë, kjo ka qenë një zyrë qendrore ku është mbledhur informacioni i klasifikuar dhe që do të ishte me vlerë për KED. Këto rregulla gjenden në ligjin për vetting-un, po ashtu sikurse ligji për statusin japin edhe mjete të tjera se si mund të mblidhet ky informacion. Pra pavarësisht nga formulimi që zgjidhet, kryesore është të konsiderohet kush është mënyra më e mirë që KED ta marrë informacionin.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve për propozimin e dispozitës së nenit 8 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 84 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për mosmiratimin e propozimit **votuan të gjithë anëtarët e Këshillit**.

Këshilli vijon punimet e mbledhjes sipas rendit të ditës, me shqyrtimin dhe diskutimin e nenit 9 të projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, për një ndryshim në pikën 104 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 9 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 104 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehim mendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e nenit 9 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 104 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Nejla Peka, merr fjalën dhe parashtron se shprehim dakordësinë me këtë ndryshim të propozuar, për faktin se, për analogji, edhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e

Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 22, shkronja “a” e pikës 2, ka parashikuar pikërisht si një nga kriteret formale ligjore për ata kandidatë që duan të konkurojnë për Prokuror të Përgjithshëm që të kenë kaluar me sukses të gjitha fazat e procesit të rivlerësimit kalimtar. Po kështu edhe ligji i Gjykatës Kushtetuese. Por, në fakt le të ndalemi pak se çfarë do të thotë të kalosh me sukses? Nëse do ta shtrijmë në aspektin praktik edhe ta krahasojmë, p.sh., sot në kuadër të reformimit që është bërë në arsimin e lartë universitar sistemi i zgjedhur të lejon të mbarosh 3 vjeçarin dhe kush nuk dëshiron të vazhdojë masterin, vetëm certifikohet. Njerëzit nuk i thonë urime dhe suksese sepse nuk ka fituar asgjë në fakt. Ajo që i intereson më shumë në jetë përveç asaj certifikate është të zërë një punë. Nuk mund të zërë një punë nëse nuk vazhdon studimin e thelluar 3 + 2, pra të bëj edhe masterin. Pra të kalosh me sukses një stad të rëndësishëm në jetë, siç mund të jetë kandidimi për efekt promovimi në aspektin profesional, do të thotë që të kalosh të gjitha fazat e atij procesi. Edhe në këtë rast, në procesin e rivlerësimit kalimtar, fazat përmbillen kur ke vendim të formës së prerë nga K.P.K ose kur K.P.A shprehet me vendim përfundimtar.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtron se për ata anëtar të këshillit që kanë qenë edhe anëtar edhe në vitin 2019, ndoshta është diskutim i përsëritur nga ana ime. Është një diskutim i ngritur mbi 4 herë nga ana ime për tu futur në rend dite dhe për tu ndryshuar ky akt nënligjor gjatë Këshillit të kaluar dhe me paralajmërimin gjithmonë se do të gjendemi në një situatë hipotetike që një anëtar i Gjykatës Kushtetuese mund të bëhet i tillë edhe pa një vendim të formës së prerë. Dhe ashtu ndodhi dhe ashtu erdhi rezultati negativ. Pra, qëllimi me të cilin u mbrojt kjo dispozitë atëherë ishte se jemi vonë, na duhet një Gjykatë Kushtetuese funksionale dhe produktin që kërkohej shpejtësi anëtarët nuk u realizuan. Ligji thotë të këtë kaluar me sukses procesin e verifikimit të pasurisë, të tijën dhe të familjarëve të tij. Dhe ligji nuk është bërë kot ashtu sepse këtu kandidojnë dy rryma, një nga jashtë sistemit dhe një nga brenda sistemit. Sukses do të thotë që Besniku nuk ishte i suksesshëm. Është shumë e qartë. Të njëjtën linjë për Prokurorin e Përgjithshëm, nuk votoi Kuvendi ndonjë pa vendim të formës së prerë. Kështu i ka rregullat KLP-ja. Nuk votoi KLP-ja emërimin e ndonjë prokurori në SPAK pa vendim të formës së prerë. Këtu organet e reja të Sistemit të Drejtësisë u vendosen në përplasje të fortë. KED-i me këto akte nënligjore thotë se ky njeri vlen për tu promovuar në organin më të lartë të drejtësisë që është Gjykata Kushtetuese. Ndërsa një organ tjetër që është Komisioneri Publik thotë që ky nuk bën të jetë pjesë e sistemit të drejtësisë. Kjo është e vërteta. Me sa duket fitoi Komisioneri Publik. Pra, i bie që dikush të këtë ceduar standardet e tij dhe ky është KED 2019. Për fat të keq, u cënua plotësisht besimi i publikut. Disa thoshin përse e zgjodhi Presidenti. Nuk bënë pyetje se kush e vendosi në listë pa vendim të formës së prerë. Pra, KED,

nuk garantoj absolutisht asnjë shpejtësi dhe është koha që edhe për ato 6 vakanca të tjera, ky rregull duhet të ndryshohet, vetting-u duhet i formës së prerë. Praktika na tregoi një rezultat negativ. Kështu që unë habitem që të ridiskutojmë a duhet ta ndryshuar apo jo ndërkohë që fakte pozitive nuk kemi.

Michelle Lakomy (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtron se Euralius dhe OPDAT besojnë se kjo është një vendimmarrje politikëbërëse e KED. Në këtë vështrim meqenëse ne jemi ekspert teknik nuk kemi një rekomandim specifik në lidhje me këtë rast. Këtu janë ngritur të gjitha argumentet nevojshme rreth kësaj çështjeje. Shembulli i sjellë në rastin e zotit Muçi dhe emërimit të tij Besnik sigurisht që ngre disa shqetësime, por kjo duhet të ekuilibrohet me nevojën për të ecur përpara me shpejtësi në mënyrë që të kemi numrin e duhur të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese që ajo të jetë funksionale.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e dispozitës së nenit 9 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 104 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët **Fiona Papajorgji, Saida Dollani, Nezir Gjoka** dhe **Arjan Qafa**. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Arta Marku, Miranda Andoni** dhe **Ludovik Dodaj**. Me rezultatin e votimit 4 vota pro dhe 5 kundër, ky propozim nuk miratohet.

Këshilli vijon punimet e mbledhjes sipas rendit të ditës, me shqyrtimin dhe diskutimin e nenit 10 të projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, për një ndryshim në pikën 105 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 10 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 105 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehim mendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e nenit 10 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 105 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Nejla Peka, merr fjalën dhe parashtron se ndoshta me një riformulim paksa më teknik edhe mund të pranohet, për ta bërë edhe më të qartë normën. Vërtet u dha sqarimi dhe tani është e kuptueshme se pse është e shkruar e kujt i është referuar, por ndoshta për të tretët, p.sh.

dhe për një kandidat që do të shprehë interesin i cili e lexon këtë vendim, një sqarim dhe një afat e vendosur aty pse jo të mos bëhet.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtro se pas rrëzimit të pikës pararendëse edhe sqarimit që ju dhatë, nuk kam asnjë koment.

Michelle Lakomy (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtro se nuk kam asnjë gjë për të shtuar në këtë pikë në lidhje me këtë propozim.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e dispozitës së nenit 10 të projektvendimit, për një ndryshim në pikën 105 të vendimit nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votuan anëtarët **Vitore Tusha** dhe **Arta Marku**. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët **Ardian Dvorani**, **Fiona Papajorgji**, **Miranda Andoni**, **Saida Dollani**, **Ludovik Dodaj**, **Nezir Gjoka** dhe **Arjan Qafa**. Me rezultatin e votimit 2 vota pro dhe 7 kundër, ky propozim nuk miratohet.

Anëtarët e Këshillit, votojnë unanimit për nenin 11 të projektvendimit mbi hyrjen në fuqi të këtij vendimi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas përfundimit të diskutimit dhe votimit për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.4, datë 11.03.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, si edhe pas këshillimit me pjesëmarrësit, për shkak edhe të nevojave të teknikës së regjistrimit audio të punimeve të mbledhjes, cakton 30 minuta pushim.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pas pushimit, përpara vijimin e punimeve të mbledhjes me shqyrtimin dhe diskutimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 5, datë 02.04.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, sipas kërkesës së tij për të komunikuar çështje organizative me mbledhjen e Këshillit, i jepet fjala Bledar Dervishajt.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtro se dua ta shpreh këtu në mbledhje të Këshillit, pavarësisht se duhet të vijë edhe me letër zyrtare nga Institucioni i Presidentit të Republikës. Nuk besoj sot, por nesër në mëngjes do të vijë patjetër për anëtarët e Këshillit dhe të gjithë Këshillin. Fakti që në datë 30 Dhjetor të këtij viti Kuvendi i Shqipërisë i është drejtuar

më një kërkesë për opinion Komisionit të Venecias lidhur me procesin e emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që i paraprin ose janë veprime të mëpasshme pas shtimit të objektit të veprimtarisë së një Komisioni të Posaçëm Hetimor në Kuvend. Ata kanë evidentuar të nevojshme të marrin disa pyetje apo këshillave në lidhje me të gjithë procesin e ndjekur mbi emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Po kështu, edhe nga Presidenti i Republikës, i është drejtuar në muajin Janar me një kërkesë të veçantë Komisionit të Venecias, për të marrë edhe ai një opinion, por pak më të gjerë se ai i kërkuar nga Kuvendi. Për pos pyetjeve që janë të shumta në numër dërguar nga Presidenti i Republikës për Komisionin e Venecias, ka edhe informacion shterues për sa i takon veprimtarisë së Këshillit 2019, veprimtarisë të Kryetarit të Këshillit, veprimtarisë së Presidentit të Republikës, veprimtarisë së Kuvendit përgjatë përzgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Nga informacioni dhe komunikimi që kemi për arsye se jemi institucion që po hartojmë bashkarisht, Kuvendi për llogari të tij dhe Presidenti për llogari të tij axhendën që do të ndjekë Komisioni i Venecias, jemi vënë në dijeni që ky Komision do të realizoj disa takime, ndërmjet të tjerave edhe me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Vlerësoj të evidentojmë që është për tu diskutuar nga Këshilli mbi formatin që do të realizohet takimi. Pra, a do të ketë një takim me Këshillin 2019, veprimtaria e të cilës është bërë objekt diskutimi dhe kërkesë për marrjen e mendimit nga President i Republikës apo me Këshillin 2020. Edhe për këtë sjellim në vëmendje që kjo çështje duhet të marrin vëmendje patjetër nga ana juaj. Në vlerësimin tonë jemi të mendimit që Komisioni i Venecias të zhvillojë të dy takimet, qoftë me Këshillin e 2019, qoftë me 2020. Për arsye se opinionin do të evidentojë faktet e Këshillit 2019, por do të ndikojë patjetër edhe në veprimtarinë e Këshillit 2020, ndoshta edhe për rishikimin e këtyre akteve nënligjore. P.sh. pjesëmarrja e Avokatit të Popullit është pjesë e informacionit tonë të dërguar në Komisionin e Venecias. Filtrimi i informacionit në DSIK, rivlerësimi kalimtar dhe qëndrimi i Këshillit po ashtu. Në këtë mënyrë e sjell në vëmendje sot, unë si përfaqësues i Presidentit, nesër do të vijë me një kërkesë me shkrim në mënyrë që Këshilli dhe Kryetari i tij të mbajnë parasysh që mundësisht ti realizojnë me të dy Këshillat. Kjo ishte për ta sjellë në vëmendjen tuaj. Prandaj e konsiderova organizative, për arsye se nuk kanë lidhje me rendin e ditës por vetëm me organizimin e takimit që ky organ apo ai i mëparshmi të realizojë më anëtarët e Komisionit të Venecias, në datën 13-14 Shkurt.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, merr fjalën dhe sqaron se komunikimet lidhur me mundësinë e takimit të delegacionit të Komisionit të Venecias me KED janë në proces dhe jemi në komunikim. Kur ato të jenë përfundimtare dhe ti komunikohen zyrtarisht Këshillit,

sipas përcaktimeve që do të ketë axhenda e vendosur me Komisionin e Venecias do ti njoftohet anëtarëve.

Këshilli vijon punimet e mbledhjes sipas rendit të ditës, me shqyrtimin dhe diskutimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 5, datë 02.04.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet në mënyrë të përmbledhur qëllimin dhe arsyet e ndërmarrjes së nismës për propozimin e këtij projektvendimit të sipërcituar për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli, duke vijuar me paraqitjen e motiveve të propozimit të nenit 1 të këtij projektvendimi.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë dhe shprehim mendimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e nenit 1 të projektvendimit për një ndryshim në pikën 39 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Nejla Peka, merr fjalën dhe shprehet se kam mendimin se propozimi duhet të pranohet.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtron se mendimin se propozimi të pranohet. Është propozim saktësues. Vetëm a do të ketë lidhje me pas me procedurat që subjekti zgjedh të shkojë të ankohet në Gjykatën e Apelit apo nuk ka lidhje me këtë moment? Meqenëse kemi pasur një rast për dy vendime në dy vakanca kur Këshilli de facto nuk kaloi në vlerësim pa u shqyrtuar ankimi i paraqitur nga kandidati në gjykatë.

Michelle Lakomy (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtron se nuk kam asgjë për të shtuar në diskutim.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, në lidhje me përmbajtjen e nenit 1 të projektvendimit për një ndryshim në pikën 39 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit **votuan të gjithë anëtarët e Këshillit**. Anëtarët **Ardian Dvorani** dhe **Fiona Papajorgji** u shprehën se në dispozitën e miratuar duhet të përfshihej edhe vendimi i ndalimit.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 2 të projektvendimit për një shtesë në pikën 37 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 2 të projektvendimit për shtesën në pikën 37 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitur për një shtesë në pikën 37 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Nejla Peka, merr fjalën dhe shprehet se jam dakord me propozimin. Edhe në gjykim të Kodit të Procedurave Administrative vendimi në këtë rast do ishte i vlefshëm për tu rishikuar. Pra KED ta rishikonte me një vendim të ndërmjetëm, për sa i përket procedurës.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashton se jemi dakord. Asgjë me shumë se sa KED ka vepruar edhe në një rast më parë. E vendosni në rregull, është shumë më mirë.

Michelle Lakomy (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashton se është vendi të merret në referencë neni 144 i Kodi të Procedurës Administrative. Referenca ime është ndryshme nga ajo që shpjegoi propozuesja. Nuk kam kundërshtim për formulimin e përdorur në këtë dispozitë, ndërkohë Kodi i Procedurave Administrative flet për një palë e cila kërkon rishikimin dhe ndërkohë nuk shprehet psh. për këshillin. Gjithsesi nuk kam kundërshtim.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, për propozimin e paraqitur për një shtesë në pikën 37 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit, por duke e vendosur përmbajtjen e normës së pika 14/1 e vendimit nr. 5 datë 02.04.2019, votuan anëtarët **Ardian Dvorani, Fiona Papajorgji, Arta Marku Miranda Andoni, Saida Dollani, Ludovik Dodaj, Nezir Gjoka** dhe **Arjan Qafa**. Për mosmiratimin e propozimit votoi anëtarja **Vitore Tusha**. Me rezultatin e votimit 8 vota pro dhe 1 kundër, ky propozim miratohet.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 3 të projektvendimit për shtesën e pikës 39/1 pas pikës 39 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 3 të projektvendimit për shtesën pikës 39/1 pas pikës 39 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitur për shtesës e pikës 39/1 pas pikës 39 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Nejla Peka, merr fjalën dhe shprehet se jam dakord me propozimin.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashton se nuk kemi komente. Dakord të pranohet propozimi.

Michelle Lakomy (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashton se nuk ka kundërshtime me propozimin.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, në lidhje me përmbajtjen e nenit 3 të projektvendimit për shtesën e pikës 39/1 pas pikës 39 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit **votuan të gjithë anëtarët e Këshillit**.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 4 të projektvendimit për një ndryshim në pikën 62 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 4 të projektvendimit për një ndryshim në pikën 62 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitur për një ndryshim në pikën 62 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Nejla Peka, merr fjalën dhe shprehet se do të më duhet të shpjegoj, pa dashur të bie në përsëritje për çka keni diskutuar në projektvendimet pararendëse, pikërisht për të qartësuar pozicionin e institucionit kombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, pra Avokatit të Popullit, funksion i njohur nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi. Më lejoni që shkurtimisht të prezantojmë qëndrimin tonë institucional për sa i përket propozimit të cilin e gjej me vend për disa arsye. *Se pari*, Kushtetuta i ka njohur funksionet e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit institucionit të Avokatit të Popullit dhe duke qenë se është i vetmi institucion kombëtar që garanton nga kjo pikëpamje mbrojtjen e të drejtave, në këtë rast dhe në këtë proces kaq delikat ku në themel qëndron mënyra se si trajtohen kandidatët që marrin pjesë në proces, pra a trajtohen në kushtet e një procesi të rregullt dhe pa shkelje të drejtave. Natyrisht që qenia e pranishme jo vetëm fizikisht, por edhe me një rol interaktiv dhe proaktiv i Avokatit të Popullit është thelbësore. Vërtet që ligji thotë se “*Mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë të mbyllura*”. Me këtë lloj përcaktimi të vendosur në ligj KED na shfaqet si një organ atipik për publikun, në një kohë kur është e qartë që në mbledhjet e tij, e gjithë veprimtaria administrative e këshillit dhe çdo lloj vendimmarrje afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo edhe publikun dhe interesat e publikut. Kjo për faktin e thjeshtë se që në krye të herës kur është folur për reformën në drejtësi dhe kur filloj zbatimi i kësaj reforme gur themeli ka qenë pikërisht rritja e besimit të publikut tek organet e reja të drejtësisë, tek brezi i magistratëve të cilët do të jenë pjesë e këtij sistemi, por njëkohësisht edhe për transparencë maksimale tek të gjitha institucionet, jo vetëm të procesit të rivlerësimit por edhe të organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Në mënyrë të logjikshme pyetja që lind vetiu është se kush ua garanton individëve dhe shoqërisë sonë këtë lloj transparence dhe këtë lloj besimi për punën e këtyre organeve. Përpos askujt tjetër, vetëm Avokati i Popullit me kompetencat kushtetuese edhe ligjore që ai gëzon si institucion kombëtar i mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe që gëzon besueshmëri maksimale, e dëshmuar kjo që në momentin krijimit në 1999 me ligjin organik për Avokatin e Popullit e në vijimësi, i akredituar në fakt edhe ndërkombëtarisht me statusin A+ në rangun e institucioneve homologe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kjo jo pa meritë por pikërisht për faktin se institucioni i Avokatit të Popullit ka dëshmuar në vite që është institucion i pavarur dhe kushtetues dhe në themel të punës së tij dhe veprimtarisë së tij administrative ka besueshmëri maksimale për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit në shoqërinë tonë. Të qenit pjesëmarrës në mbledhje për të parë nga afër në cilësinë e vëzhguesit dhe në të njëjtën kohë edhe si pjesëmarrës dhe ndjekës i veprimtarisë administrative të KED do të thotë që ligji i garanton Avokatit të Popullit, jo vetëm të qenit fizikisht i pranishëm me cilësinë vëzhguesit, pra të ndjekjes së veprimtarisë administrative dhe të gjykimit mbi këtë veprimtari dhe mbi çdo lloj hapi, procedure dhe vendimmarrje që ky organ merr kur bëhet fjalë sidomos në rastet e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve. Pra është terminologji e zgjedhur nga vetë ligji. Ndaj qenia e Avokatit të Popullit në bisedimet e çështjes si e pranishme jo vetëm fizikisht, por edhe me një rol inter-aktiv dhe pro-aktiv, gjykojmë që është në përmbushje të parashikimeve ligjore dhe kushtetuese. Pa dashur të bëj një shtjellim akoma më të zgjedhur dhe për të mos ju marrë më shumë kohë, e gjykojmë me vend propozimin dhe tërësisht të mbështetur në Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtron se nuk do e përsëris veten që kjo çështje është e njëzeta herë e kusur që diskutohet në KED 2019 dhe 2020. Sa herë jemi ndeshur, në çdo mbledhje, Avokatit i Popullit e ka ngritur këtë shqetësim. Po ashtu edhe ne si institucion e kemi ngritur që aktet nënligjore nr.4 dhe nr.5 po e kufizojnë veprimtarinë dhe kompetencat e Avokatit i Popullit, veprimtari dhe kompetenca që ia ka njohur Kushtetuta drejtpërdrejtë në nenin 179 pika 11, vetë ligji “Për funksionimin e Avokatit të Popullit” por edhe ligji nr.115. Kështu që propozimi është me se i gjetur. Kjo është edhe një pyetje që i është shtruar Komisionit të Venecias dhe do të na thonë edhe ekspertet e huaj se cili është roli i Avokatit të Popullit që ata gjithmonë e kanë në lartësinë maksimale të institucionit më të mirë për ruajtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Kështu që ky propozim jo vetëm gjen vend por është kushtetues 100%. E kam mbështetur gjithmonë dhe do ta mbështes sa herë që ngrihet si propozim.

Michelle Lakomy (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtron se besoj që EURALIUS e ka paraqitur pozicionin dje dhe unë nuk isha prezente në mbledhje. Por qëndrimi jone i unifikuar është që ky propozim nuk është ai që ne do ta rekomandonim. Interpretimi jonë i Kushtetutës është se shtimi i kësaj dispozite do të ndryshonte thellësisht rolin që i është përcaktuar në Kushtetutë dhe ligj Avokatit të Popullit. Në aspektin krahasues, detyrat e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe vëzhguesve ndërkombëtar janë të përcaktuara posaçërisht në një aneks të Kushtetues dhe nga ky vështrim nuk është shprehur në këtë mënyrë për rolin e Avokatit të Popullit në lidhje me KED. Sigurisht Avokati i Popullit ka të përgjegjësinë të raportojë çdo shkelje që konstaton në Kuvend, por ky është një rol krejtësisht i ndryshëm nga ai që propozohet nëpërmjet këtij ndryshimi që kemi përpara.

Nejla Peka, kërkon fjalën për ti drejtuar një pyetje dhe fillimisht shprehet se në fjalën tuaj përmendet që Avokati i Popullit ka të drejtë që për këtë proces, monitorimin dhe vëzhgimin e veprimtarisë e KED-së, të paraqesë raporte dhe kur flasim për një mënyrë raportimi për përgatitjen e një raporti, baza e tij janë gjetjet, problematikat e gjeneruara nga një hetim administrativ dhe në fund rekomandimet, ashtu siç është paraparë në ligjin organik të Avokatit të Popullit. Pyetja është se si duhet të përgatisim një raport që ai të jetë transparent, solid dhe në këtë rast kushtetues e ligjor, nëse ne nuk jemi dhe nuk prekim në thelb veprimtarinë administrative të një organi por të gjykojmë thjesht, vetëm në bazën e një dokumentacioni që mund të na paraqitet ose çfarë mund të elaborojmë në faqen zyrtare të KED?

Michelle Lakomy (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe përgjigjet se ju e keni mundësinë të vëzhgoni procesin, të thelloheni në vetë procesin e vendimmarrjes. Këshilli është një organ kolegjal vendimmarrës i cili normalisht kryen disa analiza gjatë vendimmarrjes së tij dhe roli juaj është që të vlerësoni procesin mbi mënyrën se si e bëjnë këtë vendimmarrje por jo të vendosni e ta zëvendësoni gjykimin tuaj me gjykimin e tyre. Në këtë pikë është edhe dallimi që bën diferencimin dhe që i mungon dispozitës së propozuar.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, në lidhje me përmbajtjen e nenit 4 të projektvendimit me të cilin propozohet një ndryshim në pikën 62 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për miratimin e propozimit votoi anëtarja *Arta Marku*. Për mosmiratimin e propozimit votuan anëtarët *Ardian Dvorani, Vitore Tusha, Fiona Papajorgji, Arta Marku Miranda Andoni, Saida Dollani, Ludovik Dodaj, Nezir Gjoka* dhe *Arjan Qafa*. Me rezultatin e votimit 1 votë pro dhe 9 kundër, ky propozim nuk miratohet.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 5 të projektvendimit për shtesën e pikës 63/1 pas pikës 63 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 5 të projektvendimit për shtesën pikës 63/1 pas pikës 63 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitur për shtesën e pikës 63/1 pas pikës 63 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Nejla Peka, merr fjalën dhe shprehet se në parim jam dakord me propozimin, ndoshta mund të kërkojë një riformulim nga pikëpamja e teknikës ligjvënëse. Në gjykim tim nuk ka asgjë të keqe nëse përfshihesh në një proces ku do të duhet të pikëzosh e të vlerësosh një kandidat bazuar në disa kritere dhe një metodologji të caktuar, pavarësisht numrit të pikëve që disponon. Në çdo rast vlerësimi është subjektiv, e dimë këtë sepse që në krye të herës në bankat e shkollës nota nuk ka qenë tregues për të bërë diferencën 9 apo 10. Një njeri që është i formuar nga pikëpamja akademike, por edhe profesionalisht, e dëshmon këtë dhe nuk është nota që bën diferencën. Por vlera e argumentimit tregon së pari që gjykimi mbi kandidaturën ka qenë i drejtë, transparent dhe objektiv. Pra në radhë të parë unë besoj që relatori apo subjekti që do të duhet të vlerësojë kandidaturën të jetë i qartë për veten e vet, pavarësisht numrit të pikëve nëse jep 8 apo 9. Secili bën një analizë kur bën një vlerësim. Në rastin më të keq nuk ka nevojë fare se është e dukshme. Por kur kandidatura që do duhet të vlerësohet është potencialisht e vlefshme nuk ka asgjë të keqe që përveç pikëzimit edhe ta argumentosh këtë pikëzim. Nuk besoj se përbën problem. Mund të hajë pak kohë, por në fakt i gjithë procesi i vlerësimit ha kohë. Ndaj ne si institucion biem dakort në parim me propozimin. Ndoshta mund të mos kthehet në detyrim, por të shikohet formulimi sepse mund të ketë raste të urgjencës kur nuk ke kohë edhe gjendesh përball faktit, dy rreshta mund ti shkruash por argumentim për çdo kriter nuk mund ta bësh.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtron se propozimi është vërtet i mirë. Ka rregullore, ka edhe standarde se si hartohet vlerësimi nga secili anëtar i Këshillit. Ajo që do të shtohesh këtij Këshillit me këtë propozim është një dokument i mëvetshëm. Pra në vendimin e zbardhur nuk do të ishin tërësia e mendimeve të të nëntë anëtarëve duke thënë që ai tha kështu apo ai tha ashtu, të ruanim të njëjtin standard dhe format vendimi, por në dosje do të përfshihesh tashmë edhe vlerësimi i secilit prej anëtarëve të Këshillit për secilin kandidat, si një punë shtesë. Pra është e vërtet e vështirë por e përealizueshme nuk është, që për çdo kriter, për

çdo tregues, për çdo indikator, kryetari, anëtari, ta bëjnë secili më vete dhe le të gjendet në dosje. I shërben të mirës së përgjithshme dhe shmang çdo keqkuptim që kandidati mund të krijojë, çdo subjektivizëm nisur edhe nga fakti që vendimi i vlerësimit nuk është i ankimueshëm në gjykatë.

Michelle Lakomy (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtron se jam dakord që duhet të ketë një metodologji. Mendoj që ka aspekte të këtij propozimi që janë shumë kufizuese. Në përgjithësi çdo Këshill do të japë argumentet të cilat do të jenë të ndryshme sepse dhe vetë përbërja e këshillit ndryshon çdo vit. Edhe pse procesi tenton gjithmonë që të jetë objektiv, gjithmonë ka një ka elemente të subjektivitetit. Por ajo çka është më e rëndësishme për të gjithë anëtarët e Këshillit kur kryejnë vlerësimin është që të ndahet nga të gjithë anëtarët kuptimi në lidhje me kriteret dhe mënyrën se si bëhet pikëzimi në bazë të këtyre kriterëve. Eksperienca ime ka qenë që pa një kuptim të përbashkët të këtij qëllimi apo të këtij kriterit që vlerësohet, të përcaktosh njerëz që duhet të bëjnë pikëzim dhe të shpjegojnë pse e bëjnë këtë pikëzim është e pakuptimtë. Është si puna e ngjyrave, në qoftë se kemi dy zgjidhje njëra është e kuqe e tjetra bluja, unë mendoj që bluja është më e bukura, është më e mira. Blusë do ti jap 5 pikë, ndërkohë që të kuqes 0 pikë. Dhe unë do të jap një shpjegim përse i dhashë këtë pikëzim të lartë sepse më pëlqen ngjyra blu apo e kundërta. E kuptoj shumë mirë shqetësimin që juve po mundoheni të ngrini dhe që mund të adresohet, por mendoj që duhet ti lihet fleksibilitetit të Këshillit që ta adresojë këtë çështje gjatë ushtrimit të detyrave të tij më vonë dhe nuk mendoj domosdoshmërisht se duhet të jetë pjesë e këtij akti.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, në lidhje me përmbajtjen e nenit 5 të projektvendimit për shtesën e pikës 63/1 pas pikës 63 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për mosmiratimin e propozimit **votuan të gjithë anëtarët e Këshillit**.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 6 të projektvendimit për një shtesë në pikën 76 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, deklaroi se e tërheq dispozitën e propozuar, duke qenë se është çështje objekt diskutimi edhe nga Komisioni i Venecias, pas të cilit Këshilli mund të ketë kohën për të reflektuar.

Këshilli vijon punimet me shqyrtimin dhe diskutimin në lidhje me përmbajtjen e nenit 7 të projektvendimit me të cilin propozohet të shfuqizohet pika 80 e vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së projektvendimit, paraqet thelbin e motiveve për propozimin e dispozitës së nenit 7 të projektvendimit për shfuqizimin e pikës 80 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Anëtarët e Këshillit, diskutojnë dhe parashtrojnë argumentet e tyre në lidhje me propozimin e paraqitur në nenin 7 të projektvendimit për shfuqizimin e pikës 80 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Nejla Peka, merr fjalën dhe shprehet se është dakord me propozimin.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtron se nuk dua të zgjatem i nderuar kryetar se ju e dini mendimin tim. Faktikisht e kuptoj dhe e kam mirëkuptuar që kjo është zgjidhja më e mirë që mund të kishte bërë Këshilli. Por Këshilli ka marrë atributet e ligjvënësit. Nëse ka probleme dispozita e ligjit dhe mund të ketë probleme se nuk e qartëson janë dy lista për secilën vakancë apo janë dy lista e këtu bëhet interpretimi. Unë mund të them që janë dy lista për secilën vakancë dhe nuk ke pse e çon një kandidat nga këtej tek vakanca tjetër. Kjo është moskuptimi që vjen nga dispozita që është ndërtuar në mënyrë jo korrekte. Por që Këshilli është munduar ta elaboroj me një rregull tranzitor duke dalë përtej dispozitës së vendosur në të dy dispozitat për Presidentin dhe për Kuvendin, por jo për Gjykatën e Lartë. Kështu që unë besoj se ky argument që është dhënë nga propozuesja duhet mbështetur dhe ta shikojmë Këshillin të sfidojë realitetin e atyre vakancave që janë sot në shqyrtim duke zbatuar dispozitën e ligjit. Kjo do të detyronte edhe ata të Kuvendit, që për të disatën herë nuk janë këtu, ta rregullojnë dispozitën se ka një vit që ka dalë ky problem.

Michelle Lakomy (përkthen përkthyesja), merr fjalën dhe parashtron se sikurse e kuptoj unë, KED ka diskutuar gjerësisht në lidhje me këtë temë në të kaluarën dhe jam dakord me arsyetimin se përse e ka vendosur këtë dispozitë në rregullore.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, në lidhje me përmbajtjen e nenit 7 të projektvendimit me të cilin propozohet shfuqizimi i pikës 80 të vendimit nr.5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi shprehën qëndrimin dhe votuan në këtë mënyrë: Për mosmiratimin e propozimit **votuan të gjithë anëtarët e Këshillit**.

Anëtarët e Këshillit, votojnë unanimit për nenin 8 të projektvendimit mbi hyrjen në fuqi të këtij vendimi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Këshilli vijon punimet e mbledhjes, sipas rendit të ditës, me shqyrtimin dhe diskutimin e pikës së fundit mbi “Ngritjen e një grupi pune për hartimin e rregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e

administrimit të çështjeve, për të përmbushur angazhimin e deklaruar të KED-së 2019 në nenin 22 të Rregullores së Brendshme”.

Marsida Xhaferllari, në cilësinë e propozueses së kësaj çështjeje të rendit të ditës, paraqet thelbin e motiveve për nevojën e përgatitjes së projektregullores së brendshme lidhur me detyrat e këshilltarëve dhe personelit administrativ të Gjykatës së Lartë të caktuar për mbështetjen e veprimtarisë së Këshillit, si edhe për veprimet e ndryshme administrative, për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve, për të përmbushur angazhimin e deklaruar të KED-së 2019 në nenin 22 të Rregullores së Brendshme.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë mbi mënyrën se si do të procedohet për përgatitjen dhe shqyrtimin e kësaj projekti rregullorjeje.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, dakordësohen që brenda një afati njëmuor, nën kujdesin e Kryetarit të Këshillit, personeli mbështetës i KED pranë Gjykatës së Lartë të përgatisë një dokument pune, projektregullore të brendshme për çështjet që lidhen me detyrat dhe veprimet e personelit mbështetës të këshillit, krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, dokumentacionit, protokollit, arkivave dhe për sistemin e administrimit të çështjeve etj.. Kjo projektregullore e përgatitur, pasi të jetë njohur nga anëtarët, do të shqyrtohet në mbledhjen e KED-së.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, në përfundim të shqyrtimit të të gjitha çështjeve të rendit të ditës, deklaroi të mbyllur mbledhjen.

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 18.55

SEKRETARE

Vilma DOKUSHI

Elona KARDHIQI

Ermelinda KADIU

Dorina DULAJ

Fabjola MUHAMETI

KRYETAR

Ardian DVORANI